

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2024

AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundi mit të kërkesës	Tarifa
1.	22.01.2024	Kërkesë për informacion per ekspozim të informacionit të klasifikuar “sekret“.	25.01.2024	Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar dhe në përgjigje të kërkesës tuaj, Ju bëjmë me dije se: Misioni i Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) është organizimi, drejtimi e kontrolli i masave për ruajtjen, klasifikimin dhe administrimin e informacionit të klasifikuar. Detyrat e AKSIK, janë të përcaktuara në ligjin nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të ligjit dhe Rregulloren e Brendshme për organizimin e funksionimit të tij. Referuar kërkesës tuaj, bëjmë me dije se, AKSIK i ka rekomanduar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme ngritjen e një komisioni për shqyrtimin e çështjes. në mbështetje të nenit 74 të ligjit 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”. Në përfundim të shqyrtimit do të ndërmerren masat përkatëse.	E plotë	Nuk ka

2.	19.01.2024	Kërkesë për informacion	31.01.2024	Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, Vendimit Nr. 188, datë 4.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”, në lidhje me kërkesën tuaj, ju bëjmë me dije si vijon: “Certifikata e sigurisë së personelit (CSP)” është dokumenti zyrtar i autoritetit shqiptar përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar ose i një autoriteti kompetent përgjegjës i sigurisë së një vendi tjetër, i cili vërteton nga pikëpamja e sigurisë se një individ i plotëson kushtet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar. Në lidhje me pyetjen e parë, ju informojmë se për vitin 2023, numri i oficerëve të DPPSH të cilëve i është refuzuar dhe hequr CSP është: - 16 raste refuzime CSP; - 4 raste heqje të CSP. Në lidhje me pyetjen e dytë, me qëllim lëshimim, pezullimin, refuzimin, pajisjen ose revokimin në mbajtjen e mëtejshme të një CSP-je, AKSIK mbështetet në shkaqet ligjore të përcaktuara në nenin 30 të ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe nenet 13 “Kërkesat e përgjithshme të vlerësimit të sigurisë” dhe 14 “Kriteret themelore të vlerësimit të sigurisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.03.2015 “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”.	E plotë	Nuk ka
----	------------	-------------------------	------------	--	---------	--------

				Në lidhje me pyetjen e tretë, ju sqarojmë se AKSIK me qëllim kryerjen e verifikimit të sigurisë, grumbullon informacione nga autoritet verifikuese. Në kuptim të Vendimit nr. 188, datë 4.03.2015 “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”, “Autoritet Verifikues” është Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH), Agjencia e Inteligjencës dhe e Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) dhe Agjencia e Mbikqyrjes Policore, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në përbërje të të cilave janë ngritur njësitë strukturore të specializuara për kryerjen e verifikimeve ndaj individëve që u nënshtrohen verifikimit të sigurisë. Në zbatim të nenit 27, të Vendimit nr. 188, datë 4.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”, njoftimi për vendimin e marrë nga AKSIK për refuzim, heqje ose pezullim të përkohshëm të CSP i komunikohet me shkrim titullarit të strukturës kërkuese.		
3.	31.01.2024	Vijim kerkese per informacion	02.02.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj, në lidhje me pyetjen e parë dhe të dytë AKSIK nuk e disponon këtë informacion. Ju lutem drejtoheni pranë DPPSH dhe AMP për kërkesën tuaj. Në lidhje me pyetjen e tretë, AKSIK në zbatim të nenit 27, të Vendimit nr. 188, datë 4.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”, ka detyrimin e njoftimit për përfundimin e verifikimit të sigurisë dhe vendimarrjen e saj titullarit të institucionit aplikues, në këtë rast DPPSH dhe AMP duke i kërkuar që punonjësi të cilit i është hequr, pezulluar apo refuzuar Certifikata e Sigurisë së	E plotë	Nuk ka

				Personelit të mos ketë qasje tek informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror”. Është përgjegjësi e titullarit të institucionit marrja e masave organizative për realizimin e misionit dhe detyrave në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Për arsye të natyrës së punës, punonjësit e AKSIK nuk mund të japin intervista publike. AKSIK vlerëson transparencën dhe me qëllim informimin e publikut është e gatshme të informojë nëpërmjet instrumentave të përcaktuara nga ligji për të drejtën e informimit.		
4.	30.01.2024	Kerkese per dhenie Informacioni per refuzim CSP	07.02.2024	Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe Vendimit Nr. 188, datë 4.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”, në lidhje me kërkesën për informacion ju bëjmë me dije si vijon: Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ndjek procedurat për lëshimin, ripajisjen, refuzimin, heqjen dhe pezullimin e “Certifikatës së sigurimit të personelit”, mbështetur në Vendimin nr. 188, datë 4.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”. AKSIK ka të drejtë të marrë vendim për refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të CSP në rastet kur, nëpërmjet autoriteteve verifikuese ose/dhe strukturave shtetërore të përfshira në procesin e verifikimit është përftuar informacion, sipas të cilit vlerësohet se pajisja ose mbajtja e mëtejshme e CSP	E pjesshme	Nuk ka

				nga një individ i caktuar përbën rrezik të papranueshëm sigurie, referuar kërkesave të legjislacionit në fuqi. Me qëllim lëshimim, pezullimin, refuzimin, pajisjen ose revokimin në mbajtjen e mëtejshme të një CSP-je, AKSIK mbështetet në shkaqet ligjore të përcaktuara në nenin 30 të ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe nenet 13 “Kërkesat e përgjithshme të vlerësimit të sigorisë” dhe 14 “Kriteret themelore të vlerësimit të sigorisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.03.2015 “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”. AKSIK për kryerjen e verifikimit të sigorisë, grumbullon informacione nga autoritet verifikuese. Në lidhje me kërkesën për vënien në dispozicion të dokumentacionit që ka shërbyer në marrjen e vendimit, ju sqarojmë se, në mbështetje të ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dokumentet e kërkuara nga ana juaj janë të klasifikuara dhe nuk mund t’ju vihen në dispozicion. Në lidhje me këtë rast, po përgatitet një relacion sqarues drejtuar Kryeministrit.		
5.	07.02.2024	Kërkesë për informacion	07.02.2024	Në përgjigje të pyetjeve të parashtruara me shkresën tuaj me nr. 686, datë 6.2.2024 adresuar AKSIK, si dhe në vijim të sqarimeve të detajuara, dhënë nga përfaqësuesit e institucionit tonë në takimin e zhvilluar me datë 9 shkurt 2024, ju bëjmë me dije se: 1. Referuar kërkesave të Ligjit Nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe të Vendimit Nr. 263, datë 12.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për	E plotë	Nuk ka

				klasifikimin e informacionit “sekret shtetëror”, “informacion i klasifikuar” është çdo dokument a material, pavarësisht nga forma, natyra ose mënyra e transmetimit të tij, i përgatitur ose që përgatitet, për të cilin është vendosur një nivel i caktuar i klasifikimit në interes të sigurimit kombëtar dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi, që kërkon mbrojtje ndaj çdo shkeljeje, shkatërrimi, përvetësimi, përhapjeje, humbjeje ose aksesit nga ndonjë individ i paautorizuar ose çdo lloj tjetër komprometimi sigurie”. Autoritete klasifikuese të drejtpërdrejta në vendin tonë janë Presidenti e Kryeministri. Titullarët e institucioneve të tjera e marrin këtë të drejtë me autorizim të Kryeministrit. Procedura e klasifikimit është e rregulluar në mënyrë të detajuar tek Vendimi Nr. 263, datë 12. 5. 2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për klasifikimin e informacionit “sekret shtetëror”. Kështu, institucioni shtetëror krijon Komisionin për Klasifikimin e Informacionit “Sekret shtetëror”, i cili kryesohet nga titullari, që është Autoritet Klasifikues. Komisioni shqyrton informacionet e propozuara për klasifikim dhe vendos për informacionin që duhet klasifikuar, rivlerësuar, nivelin e klasifikimit dhe afatin e ruajtjes së klasifikimit. Në përfundim të shqyrtimit të informacionit të propozuar për klasifikim, hartohet vendimi për listën e informacioneve të klasifikuara “Sekret shtetëror” në institucion dhe strukturat e varësisë, ku përcaktohet emërtimi i informacionit, niveli i klasifikimit dhe afati i ruajtjes së klasifikimit.		
--	--	--	--	--	--	--

				Lista e informacioneve të klasifikuara miratohet nga titullari i institucionit. Ky dokument është pika themelore e referencës në identifikimin e rasteve kur jemi përpara një prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë që përmban informacion të klasifikuar. 3. Lidhur me kategorizimin e një prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që përmban informacion të klasifikuar, ndiqen procedurat e parashikuara në Vendimin Nr. 542, datë 29.09.2021 të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit të mbrojtjes dhe të sigurisë”. Kushtet paraprake dhe specifikat lidhur me këtë proces janë parashikuar në mënyrë specifike në përmbajtjen e neneve 32 e 33 të VKM së sipërcituar. Kështu, në nenin 32, të VKM, është përcaktuar se “ka të drejtë për inicimin e procedurave për kryerjen e një prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, që përmban informacion të klasifikuar, çdo institucion shtetëror i interesuar, i cili: a) gjatë veprimtarisë së tij prodhon, administron, qarkullon informacion të klasifikuar dhe ka listën e informacioneve të klasifikuara, të miratuar sipas legjislacionit në fuqi; b) plotëson detyrimet e parashikuara për sigurinë fizike, sigurinë e personelit, sigurinë e informacionit, sigurinë e sistemeve të komunikimit dhe të informacionit dhe sigurinë e informacionit të klasifikuar në fushën industriale, sipas përcaktimeve në këtë vendim”.		
--	--	--	--	--	--	--

				Nga ana tjetër, në nenin 33 të VKM, përcaktohet procedura për klasifikimin e prokurimit. Në përmbajtjen e këtij neni specifikohet mënyra se si duhet të veprojnë institucioni shtetëror dhe roli i AKSIK (ish-DSIK) në këtë proces. Në germën “ç” të këtij neni nënvizohet se vetëm pas konfirmimit të përputhshmërisë nga titullari i AKSIK (ish-DSIK) për trajtimin e rastit si prokurim në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, i cili përmban informacion të klasifikuar, titullari i autoritetit kontraktor dhe, sipas rastit, titullari i institucionit përfitues vijnë ndjekjen e procedurave të mëtejshme, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. 4. Lidhur me referencat e paraqitura në pikën 3 të shkresës tuaj nr. 686, datë 6.02.2024 adresuar AKSIK, ju konfirmojmë se rasti nuk ka qenë objekt shqyrtimi nga AKSIK (DSIK), pasi nuk jemi në kushtet e një prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, i cili përmban informacion të klasifikuar. 5. Lidhur me vlefshmërinë dhe njohjen në vendin tonë të CSP të lëshuara nga një vend i BE, ju konfirmojmë se: Në nenin 10 të Vendimit Nr. 542, datë 29.9.2021 të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit të mbrojtjes dhe të sigurisë”, është përcaktuar “Konfirmimi i vlefshmërisë së CSI-së dhe CSP-së”. Në pikën 1 të këtij neni theksohet: “Autoriteti përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar njëson dhe konfirmon afatin e vlefshmërisë, nivelin dhe tipin e CSI-së e CSP-së të		
--	--	--	--	---	--	--

				cilat janë lëshuar nga një autoritet kompetent, përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar të një vendi anëtar të NATO-s, BE-së ose të një shteti me të cilin është nënshkruar dhe ka hyrë në fuqi marrëveshja e sigurisë”.		
6.	06.02.2024	Kërkesë për informacion	14.02.2024	Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe Vendimit Nr. 188, datë 4.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”, në lidhje me kërkesën për informacion ju bëjmë me dije si vijon: Pajisja me CSP realizohet vetëm pas kërkesës zyrtare që i adresohet AKSIK nga Autoriteti i Sigurimit Kombëtar (NSA) i shtetit të huaj, (duhet të jetë vend anëtar i NATO-s, BE-së, ose vend me të cilin Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje sigurie të përbashkët për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar); apo përmes autoritetit kompetent të sigurisë së NATO-s, të një strukture të saj, apo të BE-së. Aplikanti plotëson dokumentacionin e kërkuar. AKSIK kryen procedurat e verifikimit të sigurisë dhe në përfundim, nëse konkludon për lëshim e CSP, i adreson përgjigjen strukturës që ka paraqitur kërkesën.	E plotë	Nuk ka
7.	22.02.2024	Kërkesë për informacion	06.03.2024	Në përgjigje të pyetjeve të parashtruara në e-mailin Tuaj adresuar Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), si dhe referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe akteve nënligjore në fuqi për informacionin e klasifikuar, ju sqarojmë se:	E plotë	Nuk ka

				- Znj. [REDACTED] është e pajisur me CSP¹. - Pajisja me CSP e Znj. [REDACTED] është kryer në përputhje me procedurat e parashikuara në Vendimin Nr. 188, datë 4.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”. Znj. [REDACTED], është e pajisur me Certifikatën e Sigurisë së Personelit (CSP) më datë 5.07.2019, e vlefshme deri më datë 04.07.2024. - Z. [REDACTED] nuk është i pajisur me CSP. Aktualisht, jemi duke ndjekur procedurat e verifikimit të sigurisë për Z. [REDACTED] referuar afateve të përcaktuara në nenin 18, të Vendimit Nr. 188, datë 04.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”.		
8.	29.02.2024	Deklasifikimi i nje dokumenti	6.3.2024	Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror””, në lidhje me kërkesën tuaj, ju bëjmë me dije si vijon:	E plotë	Nuk ka

¹ Bazuar në ligjin Nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, “Certifikata e Sigurisë së Personelit (CSP)” është dokumenti zyrtar i autoritetit shqiptar përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar ose i një autoriteti kompetent përgjegjës i sigurisë së një vendi tjetër, **i cili vërtetohet nga pikëpamja e sigurisë se një individ i plotëson kushtet e përcaktuara** për njohjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar.

				Deklasifikimi është heqja e çdo klasifikimi të sigurisë. Deklasifikimi i informacionit të klasifikuar është në dy lloje: a) “Deklasifikim i plotë”, procesi i ndryshimit të autorizuar të statusit të një informacioni të klasifikuar “sekret shtetëror” në një informacion të paklasifikuar; b) “Deklasifikim i pjesshëm”, procesi i ndryshimit të autorizuar të statusit të një pjese të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” në informacion të paklasifikuar. Në mbështetje të pikës 2, të nenit 22, të ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, informacioni mund të deklasifikohet: a) me ndodhinë e një ngjarjeje apo të një date të veçantë, siç përcaktohet nga autoriteti i klasifikimit të informacionit; b) me përfundimin e afatit kohor për klasifikim; c) kur publikimi i tij diktohet nga interesa më të rëndësishme shtetërore, sesa nevoja për ta mbajtur atë të klasifikuar; ç) me kërkesë të gjykatës, kur informacioni i klasifikuar është sekuestruar nga organi procedues në përputhje me Kodin e Procedurës Penale. Në zbatim të nenit 5 të Vendimit nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror””, përcaktohet se, “Kërkesa për deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” i drejtohet Komisioni i Deklasifikimit, Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” (KDZH) dhe mund të paraqitet nga:		
--	--	--	--	---	--	--

				a) fondkrijuesi; b) fondruajtësi; c) çdo punonjës apo strukturë e interesuar brenda ministrisë apo institucionit; ç) çdo person fizik apo juridik”. Në përfundim të shqyrtimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, KDZH vendos: a. deklasifikimin e plotë ose deklasifikimin e pjesshëm të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”; b. përjashtimin nga deklasifikimi të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”; c. zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, duke përcaktuar edhe afatin e ri të ruajtjes së klasifikimit. Me qëllim që kërkesa juaj të trajtohet, ajo duhet të përmbajë kriteret ligjore të sipërcituara.		
9.	02.04.2024	Kërkesë për informacion	16.4.2024	Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe në përgjigje të kërkesës tuaj, Ju bëjmë me dije se: Lista e informacioneve të klasifikuara e Ministrisë së Brendshme dhe strukturave në varësi të saj, ku përfshihet dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, është miratuar nga Autoriteti Klasifikues, në këtë rast, Ministria e Brendshme dhe është hartuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për informacionin e klasifikuar.	E plotë	Nuk ka

				Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) nuk ka konstatuar klasifikimin e parregullt në kuptim të nenit 17 të ligjit 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”. Në lidhje me kërkesën tuaj nëse ka informacion të klasifikuar për Z. [REDACTED] ju sqaroj se, AKSIK kryen detyrat e përcaktuara në ligjin 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe ligjin Nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Me verifikim të sigorisë kuptohet tërësia e masave dhe e procedurave të aplikuara ndaj një individi, mbi bazën e të cilave do të vlerësohet lëshimi, refuzimi, pezullimi i përkohshëm ose heqja e “Certifikatës së Sigurimit të Personelit”. Verifikimi i sigorisë dhe mbledhja e informacioneve, kryhet për ata individë të cilët për shkak të funksionit të caktuar zyrtar dhe me qëllim përmbushjen e një detyre funksionale do të kenë akses tek informacioni i klasifikuar. AKSIK nuk kryen verifikimin e pastërtisë së figurës ndaj jush dhe nuk mbledh apo verifikon informacion në ngarkimin tuaj, pasi nuk jeni subjekt i ligjeve të sipërcituara.		
10.	08.04.2024	Kërkesë për informacion	22.04.2024	Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe në përgjigje të kërkesës tuaj, Ju bëjmë me dije se, Në lidhje me kërkesën për vënien në dispozicion të dosjes/praktikës për refuzimin e CSP, ju informojmë se në mbështetje të ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e	E plotë	Nuk ka

				klasifikuar”, dokumentet e kërkuara nga ana juaj janë të klasifikuara dhe nuk mund t’ju vihen në dispozicion. Në lidhje me kërkesën për kopje të vendimit për refuzimin e CSP, bashkëlidhur gjeni kopje të njësuar me origjinalin të vendimit për refuzimin e CSP.		
11.	11.04.2024	Kerkese per klasifikim informacioni	25.04.2024	Në përgjigje të e-mailit Tuaj adresuar Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), si dhe referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe akteve nënligjore në fuqi për informacionin e klasifikuar, ju sqarojmë se: Së pari, ju nuk identifikoni institucionin nga i cili kërkon që të klasifikohet informacioni. Në mbështetje të ligjit nr. 10/2023, “Autoritete klasifikuese” të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë janë: a. Presidenti i Republikës; b. Kryeministri. Titullarët e institucioneve të tjera e marrin këtë të drejtë me autorizim nga Kryeministri. Çdo institucion shtetëror, kur e gjykon se aparati dhe strukturat në varësi të tij prodhojnë informacion që lidhet me sigurinë kombëtare dhe që duhet të klasifikohet “sekret shtetëror”, i paraqet kërkesë AKSIK për pajisjen e titullarit të institucionit me autorizimin “Autoritet Klasifikues” nga Kryeministri. Në çdo institucion shtetëror krijohet Komisioni për klasifikimin “sekret shtetëror” të informacionit. Komisioni shqyrton informacionet e propozuara për klasifikim dhe vendos për informacionin që duhet klasifikuar ose rivlerësuar, për nivelin e klasifikimit	E plotë	Nuk ka

				dhe afatin e ruajtjes së klasifikimit kur lidhet me sigurinë kombëtare në përputhje me kategoritë e klasifikimit sipas nenit 10, të ligjit nr.10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”. Në përfundim të shqyrtimit të informacionit të propozuar për klasifikim, sekretari i komisionit harton vendimin për listën e informacioneve të klasifikuara “sekret shtetëror” në institucion dhe strukturat e varësisë, ku përcaktohet emërtimi i informacionit, niveli i klasifikimit dhe afati i ruajtjes së klasifikimit. Vendimi për listën e informacioneve të klasifikuara “sekret shtetëror” në institucion dhe në strukturat e varësisë nënshkruhet nga Autoriteti klasifikues dhe anëtarët e komisionit. Çdo anëtar i komisionit ka të drejtën e votës “pro” ose “kundër”. Anëtar, i cili voton “kundër”, duhet të paraqesë me shkrim arsyet e votimit “kundër”. Sa sipër, është ne vendimarrjen e Komisionit të ngritur pranë institucioneve nëse një informacion do të klasifikohet apo jo.		
12.	30.04.2024	Kërkesë për informacion	26.06.2023	Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.03.2015 “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”, dhe në përgjigje të kërkesës tuaj, Ju bëjmë me dije se: Referuar nenit 4 të Vendimit nr. 188, datë 4.03.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për sigurimin e personelit” janë përcaktuar kriteret për njohjen e informacionit të klasifikuar. Sipas nenit 4, kanë të drejtë të njihen, të ruajnë, të administrojnë e të	E plotë	Nuk ka

				transferojnë informacion të klasifikuar vetëm individët që: a. sigurojnë të drejtën e njohjes nga titullari i ministrisë/institucionit, ose oficeri i sigurimit industrial i kontraktorit për shkak të detyrës që kryejnë; b. kanë zotësi të plotë për të vepruar; c. janë të brifuar më parë për njohjen e procedurave të sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe të përgjegjësiive individuale për shkeljet e sigurisë; ç. janë të pajisur me Certifikatë të Sigurimit të Personelit (CSP), me përjashtim të rasteve për njohjen me informacionin e klasifikuar në nivelin “I kufizuar”. Referuar legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar si dhe praktikës së konsoliduar ndër vite nga DSIK, në cilësinë e autoritetit të sigurimit kombëtar, me parimin “nevojë për njohje” kuptohet nevoja për të pasur qasje tek informacioni i klasifikuar në kuadrin e një funksioni të caktuar zyrtar dhe me qëllim përmbushjen e një detyre funksionale. E drejta “nevojë për njohje” sigurohet nga titullari, të cilit me ligj i është deleguar e drejta e klasifikimit origjinal. Pra, për t’u njohur me një informacion të klasifikuar duhet: 1. Të plotësosh kushtet të pajisesh me CSP; 2. Miratimi i titullarit të institucionit që e ka prodhuar informacionin; 3. Zbatimi i parimit “nevojë për njohje”.		
--	--	--	--	--	--	--

13.	30.04.2024	Kërkesë për informacion	15.5.2024	Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe në përgjigje të kërkesës tuaj, Ju bëjmë me dije se: Në kuptim të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, me termin “e dhënë gjyqësore” kuptojmë çdo të dhënë lidhur me vendimet në fushën e gjykimeve penale, civile, administrative apo me dokumentimet në regjistrat penalë, civilë, ato të dënimeve administrative. Referuar ligjit të sipërcituar këto të dhëna konsiderohen të dhëna personale dhe nuk mund t’jua vëmë në dispozicion. Ju mund t’i aksesoni këto të dhëna vetëm nëpërmjet gjykatës.	E refuzuar	Nuk ka
14.	14.6.2024	Kërkesë për informacion	05.07.2024	Duke ju kërkuar ndjesë për vonesën, në lidhje me kërkesën Tuaj datë 14.06.2024, Ju informoj se: Kërkesa për informacion në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë <u>identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij.</u> Në zbatim të pikës 4 të nenit 14 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar, për arsye se kërkesa për informim nuk përmban elementet e mësipërme, Ju refuzohet dhënia e tij në formën e kërkuar. Me qëllim kthimin e përgjigjes, ju lutem, përcillni ID dhe nënshkrimin në kërkesën tuaj.	E plotë	Nuk ka

15.	24.06.2024	Kërkesë rivlerësimi	subjekt	28.06.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 26.06.2024, në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror””, Ju informojmë si në vijim: 1. Në lidhje me kërkesën Tuaj për deklasifikimin e plotë të informacionit, ju sqarojmë: Në rastin kur Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar (KDZH) në një institucion shtetëror shqyrton deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” që nuk është prodhuar nga ky institucion, fton të marrë pjesë në mbledhje një përfaqësues nga institucioni origjinator i cili ka prodhuar informacionin. Në zbatim të Vendimit nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror””, në përfundim të shqyrtimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, KDZH vendos: d. deklasifikimin e plotë ose deklasifikimin e pjesshëm të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”; e. përjashtimin nga deklasifikimi të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”; f. zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, duke përcaktuar edhe afatin e ri të ruajtjes së klasifikimit.	Pjesërisht	Nuk ka
-----	------------	------------------------	---------	------------	--	------------	--------

				Në rastin Tuaj, AKSIK ka ftuar të marrë pjesë në KDZH, përfaqësuesin e institucionit i cili është origjinator i informacionit të klasifikuar. KDZH është mbledhur në AKSIK dhe ka gjykuar deklasifikimin e pjesshëm të raportit, përkatësisht: Me vendim nr. 38, datë 30.01.2023 KDZH ka deklasifikuar pjesërisht raportin nr. 265 Prot., datë 23.01.2023. Në lidhje me kërkesën Tuaj për vënien në dispozicion të dokumentacionit të administruar në ngarkim të subjektit [REDAKTUAR] pranë AKSIK apo çdo institucioni tjetër, ju sqarojmë se: Raporti i cili hartohet nga Grupi i Punës për Kontrollin e Figurës përmban të dhëna dhe informacione të përfutuara nga Autoritetet Verifikuese, të cilat janë të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar dhe nuk mund t'ju vihen në dispozicion.		
16.	01.08.2024	Kërkesë për informacion	09.08.2024	Në përgjigje të kërkesës Tuaj, datë 1.8.2024, me lëndë “Kërkese për informacion” dhe në mbështetje të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” Ju informojmë se, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar kryen detyrat e përcaktuara në ligjin Nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar dhe ligjin Nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.	E plotë	Nuk ka

				Verifikimi i sigurisë dhe mbledhja e informacioneve, kryhet për ata individë të cilët për shkak të funksionit të caktuar zyrtar dhe me qëllim përmbushjen e një detyre funksionale do të kenë akses tek informacioni i klasifikuar. Gjithashtu, AKSIK kryen verifikimin e subjekteve të rivlerësimit, gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatim të detyrimeve të ligjit Nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. AKSIK nuk kryen verifikimin e pastërtisë së figurës ndaj jush dhe nuk mbledh apo verifikon informacion në ngarkimin tuaj, pasi nuk jeni subjekt i ligjeve të sipërcituara.		
17.	22.08.2024	Kërkesë informacion për	28.08.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj adresuar në e-mailin zyrtar të sekretarisë së AKSIK më datë 23.08.2024 për tu informuar në lidhje me refuzimin e Certifikatës së Sigurisë së Personelit (CSP), ju informojmë se: Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) është mbështetur në shkaqet ligjore të përcaktuara në nenin 30 të ligjit 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe nenet 13 “Kërkesat e përgjithshme të vlerësimit të sigurisë” dhe 14 “Kriteret themelore të vlerësimit të sigurisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 04.03.2015 “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”. Vlerësimi i sigurisë nga AKSIK është bazuar në informacione të klasifikuara, të përftuara nga autoritetet verifikuese.	E plotë	Nuk ka

				Lidhur me kërkesën për vënien në dispozicion të një kopje të vendimit të refuzimit të CSP lutemi gjeni bashkëlidhur kopjen e Vendimit “Për refuzimin e Certifikatës së Sigurisë së Personelit për Z. [REDACTED]”.		
18.	27.08.2024		04.09.2024	Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, Vendimit nr. 188, datë 4.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit” dhe në përgjigje tuajës, ju sqarojmë se: Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ndjek procedurat për lëshimin, ripajisjen, refuzimin, heqjen dhe pezullimin e përkohshëm të “Certifikatës së sigurisë së personelit”, mbështetur në ligjin nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe Vendimin nr. 188, datë 4.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”. AKSIK ka të drejtë të marrë vendim për refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të CSP në rastet kur, nëpërmjet autoriteteve verifikuese ose/dhe strukturave shtetërore të përfshira në procesin e verifikimit të sigurisë është përfutur informacion, sipas të cilit vlerësohet se pajisja ose mbajtja e mëtejshme e CSP nga një individ i caktuar përbën rrezik të papranueshëm sigurie, referuar kërkesave të legjislacionit në fuqi. Në zbatim të nenit 27, të Vendimit nr. 188, datë 4.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e	E Plotë	Nuk ka

				rregullave për sigurimin e personelit”, njoftimi për vendimin e marrë nga AKSIK për refuzim, heqje ose pezullim të përkohshëm të CSP i komunikohet me shkrim titullarit të strukturës kërkuese, i cili ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim për rishqyrtimin e vendimit të marrë nga AKSIK. Kjo kërkesë i adresohet titullarit të AKSIK brenda 15 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit për refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të CSP. Titullari i AKSIK shqyrton dhe vendos për kërkesën e paraqitur brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e pranimi të saj. Në rastet e mospajtimit me përgjigjen e titullarit të AKISK brenda 15 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit, titullari i strukturës kërkuese ka të drejtë ta ankimojë atë me shkrim tek Kryeministri. Në rastin konkret, në AKSIK nuk është paraqitur asnjë kërkesë me shkrim nga titullari i strukturës kërkuese, për rishqyrtimin e vendimit të marrë nga AKSIK.		
19.	03.10.2024	Kërkesë për informacion	08.10.2024	Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjit nr.10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.03.2015 “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”, në lidhje me kërkesën për informacion, ju bëjmë me dije si vijon:	Pjesërisht	Nuk ka

				- Në lidhje me pyetjen e parë ju informojme se subjekti Z[REDACTED] është pajisur me certifikatë sigurie personeli (CSP) nga AKSIK. - Në lidhje me pyetjen e dytë ju informojmë se CSP për Z[REDACTED] është lëshuar më datë 22.04.2024 e vlefshme deri më datë 21.04.2029. Pajisja me CSP e Z[REDACTED] është kryer në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.188, datë 4.03.2015 “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”. - Në lidhje me pyetjen e tretë, ju informojmë se ky proces ka përfunduar duke u bazuar në memon e klasifikuar të nivelit “Sekret” të datës 22.04.2024 dhe me shkresën nr. 2265 prot., datë 25.04.2024, CSP i është dërguar institucionit kërkuar. Ju sqarojme se, për njohjen me cdo dokument që përmban informacion të klasifikuar “sekret” duhet të ekzistojnë rrethanat e parashikuara në nenin 28, të ligjit nr.10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”.		
20.	30.09.2024	Kërkesë për informacion	11.10.2024	Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjit nr.10/2023 “Për	E plotë	Nuk ka

				informacionin e klasifikuar”, dhe kërkesës tuaj për fshirjen e të dhënave dhe pastrimin e figurës tuaj, ju bëjmë me dije si vijon: Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), kryen detyrat e përcaktuara në ligjin nr.10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe ligjin nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Me verifikim të sigurisë kuptohet tërësia e masave dhe e procedurave të aplikuara ndaj një individi, mbi bazën e të cilave do të vlerësohet lëshimi, refuzimi, pezullimi i përkohshëm ose heqja e “Certifikatës së Sigurimit të Personelit”. Verifikimi i sigurisë dhe mbledhja e informacioneve, kryhet për ata individë të cilët për shkak të funksionit të caktuar zyrtar dhe me qëllim përmbushjen e një detyre funksionale do të kenë akses tek informacioni i klasifikuar. Gjithashtu, AKSIK kryen verifikimin e subjekteve të rivlerësimit, gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatim të detyrimeve të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. AKSIK nuk kryen verifikimin e pastërtisë së figurës ndaj jush dhe nuk mbledh apo verifikon informacion në ngarkimin tuaj, pasi nuk jeni subjekt i ligjeve të sipërcituara.		
--	--	--	--	--	--	--

21.	04.10.2024	Kërkesë për informacion	11.10.2024	Referuar kërkesës tuaj, dërguar me e-mailin e datës 04.10.2024 ju bëjmë me dije si më poshtë: 1. Znj. [REDACTED] (Ka filluar procesi i verifikimit të sigurisë) 2. Znj. [REDACTED] (Ka filluar procesi i verifikimit të sigurisë) 3. Znj. [REDACTED] (Ka filluar procesi i verifikimit të sigurisë) 4. Z. [REDACTED] (Nuk kemi kërkesë për pajisje me CSP) 5. Z. [REDACTED] (Nuk kemi kërkesë për pajisje me CSP) 6. Z. [REDACTED] (I pajisur me CSP për njohje me informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror" në nivelin "Sekret" me afat vlefshmërie deri më 18.08.2029) 7. Z. [REDACTED] (Nuk kemi kërkesë për pajisje me CSP) Bazuar në nenin 18 të VKM-së nr. 188, datë 04.03.2015 "Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit", "Afati i përgjithshëm për kryerjen e procedurave të verifikimit dhe lëshimit të CSP-së nga DSIK-ja (aktualisht AKSIK) është deri në 120 ditë kalendarike.	E plotë	Nuk ka
-----	------------	-------------------------	------------	--	---------	--------

				<i>Brenda kësaj periudhe përfshihen edhe afatet e verifikimit të sigurisë nga ana e autoriteteve verifikuese.</i> <i>Ky afat mund të jetë më i gjatë kur verifikimet kushtëzohen nga kryerja e procedurave në bashkëpunim me autoritetet e sigurimit kombëtar të vendeve të tjera ose kur drejtori i DSIK-së udhëzon kryerjen e verifikimeve shtesë.</i> <i>Afati i përgjithshëm për kryerjen e procedurave të verifikimit fillon vetëm pas paraqitjes së plotë dhe pranimit të dokumentacionit nga ana e DSIK-së.</i> <i>Autoriteti verifikues dhe çdo strukturë tjetër shtetërore, që merr kërkesën e paraqitur nga DSIK-ja për të kryer verifikimin e sigurisë, ka detyrimin të kryejë procedurat dhe të kthejë përgjigje duke dhënë informacionin e kërkuar me shkrim, jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e marrjes së kërkesës.</i> <i>Për raste të veçanta, me kërkesë të arsyetuar të titullarit të autoritetit verifikues dhe me miratim të drejtorit të DSIK-së, ky afat mund të zgjatet edhe 30 ditë të tjera kalendarike”.</i>		
22.	01.11.2024	Kërkesë informacion për	18.11.2024	Në mbështetje të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjit nr.10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe në përgjigje të kërkesës tuaj, protokolluar në AKSIK me nr.6137 prot., datë 01.11.2024, Ju bëjmë me dije se: ➤ Oficeri i Policisë Z. [REDAKTUAR] nuk është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli.	Plotë	Nuk ka

				➤ Në lidhje me pyetjen tuaj për arsyet e mospajisjes me CSP, AKSIK me qëllim lëshimim, pezullimin, refuzimin, pajisjen ose revokimin në mbajtjen e mëtejshme të një CSP-je, mbështetet në shkaqet ligjore të përcaktuara në nenin 30 të ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe nenet 13 “Kërkesat e përgjithshme të vlerësimit të sigurisë” dhe 14 “Kriteret themelore të vlerësimit të sigurisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.03.2015 “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”. ➤ AKSIK në zbatim të nenit 27, të Vendimit nr. 188, datë 4.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”, ka detyrimin e njoftimit për përfundimin e verifikimit të sigurisë dhe vendimarrjen e saj titullarit të institucionit aplikues, në këtë rast DPPSH duke i kërkuar që punonjësi të cilit i është hequr, pezulluar apo refuzuar Certifikata e Sigurisë së Personelit të mos ketë qasje tek informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror”. ➤ Është përgjegjësi e titullarit të institucionit marrja e masave organizative për realizimin e misionit dhe detyrave në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.		
23.	23.10.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion dokumentacioni	05.11.2024	Në mbështetje të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjit nr.10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe në përgjigje të kërkesës tuaj, protokolluar në AKSIK me nr.68 prot., datë 23.10.2024, Ju bëjmë me dije se:	Pjesërisht	Nuk ka

				Mbështetur në pikën 2 të nenit 27, të ligjit nr.10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, <i>“lëshimi, refuzimi, pezullimi i përkohshëm ose heqja e CSP bëhet nga AKSIK”</i>, referuar kriterëve themelore të vlerësimit të sigurisë të parashikuara në nenin 30, të ligjit të sipërcituar dhe të përcaktimeve të bëra në nenet 13 e 14 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.188, datë 04.03.2015 “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”. Vendimi për refuzimin e pajisjes me CSP është marrë në përputhje me referencat e mësipërme ligjore, pasi më parë janë aplikuar procedurat e verifikimit të sigurisë konform përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, duke bashkëpunuar me Autoritetet Verifikuese dhe institucionet e tjera shtetërore. Në lidhje me kërkesën tuaj për vënien në dispozicion të dokumentacionit që ka shërbyer në marrjen e vendimit, ju sqarojmë se, për njohjen me çdo dokument që përmban informacion të klasifikuar “sekret”, duhet të ekzistojnë rrethanat e parashikuara në nenin 28, të ligjit nr.10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”. Gjithashtu, në pikën 3 të nenit 27 të ligjit nr.10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, është parashikuar se: <i>“Kur ekspozohet informacioni i klasifikuar apo për shkak të një kushti, të përcaktuar nga qeveria e një shteti tjetër, arsyet e refuzimit, pezullimit të përkohshëm apo heqjes së CSP-së nuk i bëhen me dije individit, institucionit kërkues apo operatorit ekonomik”</i>.		
--	--	--	--	---	--	--

24.	16.12.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion	30.12.2024	Në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe në përgjigje të kërkesës tuaj protokolluar në AKSIK me nr.82 prot., datë 16.12.2024, Ju bëjmë me dije se: Shkresa nr. 2575 prot., datë 18.09.2024 “Për heqjen e certifikatës së sigurisë së personelit”, është prodhuar nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore dhe për këtë arsye nuk mund t’ju vihet në dispozicion nga AKSIK. Kërkesa për dokumentacionin e kërkuar duhet drejtuar pranë institucionit të origjinës.	Refuzuar	Nuk ka
25.	12.12.2024	Kërkesë për informacion	19.12.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj nr.672 Prot., datë 1.12.2024, me lëndë “Përcillet ankesa e Z. [REDAKTUAR] dhe kërkohet informacion mbi trajtimin e saj”, protokolluar në AKSIK në datë 12.12.2024 sqarojmë se: Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), pas marrjes së kërkesës me lëndë: “Vënia në dispozicion e arsyes së refuzimit të pajisjes me Certifikatën e Sigurisë së personelit” nga Z. [REDAKTUAR], protokolluar në AKSIK me nr.68 Prot., datë 23.10.2024, ka kthyer përgjigje me shkresën nr.6223 Prot., datë 05.11.2024, ku është sqaruar në mënyrë shteruese në lidhje me kërkesën për vënien në dispozicion të dokumentacionit që ka shërbyer në marrjen e vendimit për refuzimin e CSP. Gjithashtu, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr.6915 prot., datë 05.12.2024 me lëndë “Kthim përgjigje në kuadrin e ankesës së Z. [REDAKTUAR]” i ka kthyer përgjigje dhe kërkesës për informacion të ardhur nga Komisioneri për	Pjesërisht	Nuk ka

				të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në lidhje me kërkesën për vënien në dispozicion të dokumentacionit që ka shërbyer në marrjen e vendimit për refuzimin e CSP së Z. [REDAKTUAR] Për sa më sipër bashkëlidhur ju dërgojmë: 1. Kopje të kërkesës së Z. [REDAKTUAR] me lëndë “Vënia në dispozicion e arsyes së refuzimit të pajisjes me Certifikatën e Sigurisë së personelit”, protokolluar në AKSIK me nr.68 Prot., datë 23.10.2024, 8 (tetë) fletë. 2. Kopje të shkresës së AKSIK drejtuar Z. [REDAKTUAR] me lëndë “Kthim përgjigje kërkesës për informacion”, nr.6223 prot., datë 05.11.2024, 2 (dy) fletë. 3. Kopje të shkresës së AKSIK drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me lëndë “Kthim përgjigje në kuadër të ankesës së Z. [REDAKTUAR], nr. 6915 prot., datë 05.12.2024, 1 (një) fletë.		
26.	20.12.2024	Kërkesë informacion për	09.01.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj Nr.K2/M31-2 Prot., datë 18.12.2024, me lëndë “Përcillet ankesa e Z. [REDAKTUAR] dhe kërkohet informacion mbi trajtimin e saj”, protokolluar në AKSIK në datë 20.12.2024 sqarojmë se: Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), pas marrjes së kërkesës me lëndë: “Vënia në dispozicion e arsyes së refuzimit të	Pjesërisht	Nuk ka

				pajisjes me Certifikatën e Sigurisë së personelit” nga Z. [REDAKTUAR], protokolluar në AKSIK me nr.68 Prot., datë 23.10.2024, ka kthyer përgjigje me shkresën nr.6223 Prot., datë 05.11.2024, ku është sqaruar në mënyrë shteruese në lidhje me kërkesën për vënien në dispozicion të dokumentacionit që ka shërbyer në marrjen e vendimit për refuzimin e CSP. AKSIK ndjek procedurat për lëshimin, ripajisjen, refuzimin, heqjen dhe pezullimin e “Certifikatës së sigurimit të personelit”, mbështetur në Vendimin nr. 731, datë 27.11.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për sigurimin e personelit”. AKSIK ka të drejtë të marrë vendim për refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të CSP në rastet kur, nëpërmjet autoriteteve verifikuese ose/dhe strukturave shtetërore të përfshira në procesin e verifikimit është përftuar informacion, sipas të cilit vlerësohet se pajisja ose mbajtja e mëtejshme e CSP nga një individ i caktuar përbën rrezik të papranueshëm sigurie, referuar kërkesave të legjislacionit në fuqi. Në lidhje me kërkesën tuaj për arsyet e mospajisjes me CSP, AKSIK me qëllim lëshimim, pezullimin, refuzimin, pajisjen ose revokimin në mbajtjen e mëtejshme të një CSP-je, mbështetet në shkaqet ligjore të përcaktuara në nenin 30 të ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe nenet 12 “Kërkesat për vlerësimin e rrezikut të papranueshëm të sigurisë” dhe nenit 10 “Kushtet për fillimin e verifikimit të sigurisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 731, datë 27.11.2024, “Për miratimin e rregullores për sigurimin e personelit”.		
--	--	--	--	--	--	--

				<i>Aplikanti në çdo rast ka të drejtë të ankimojë vendimin në rrugë gjyqësore.</i> Në mbështetje të nenit 29 të vendimit të sipërpërmendur, aplikanti të cilit i është refuzuar CSP ka të drejtë të riaplikojë përsëri me kusht që të ketë kaluar një vit kalendarik nga data e shkresës njoftuese për heqjen ose refuzimin e CSP-së.		
--	--	--	--	---	--	--